



Republika e Shqipërisë
Ministria e Integritimit



Support to Albanian
Ministry of European Integration

MANUAL

PËR PËRKTHIMIN E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË ANGLISHT



Projekt i financuar nga
Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane



Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development



Projekt i zbatuar nga
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INTEGRIMIT EUROPIAN

MANUAL

**PËR PËRKTHIMIN E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR NË GJUHËN
ANGLEZE NË KUADËR TË INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EUROPIAN**

TIRANË, 2011

Botim i:
Ministrisë së Integrimit Europian

Ky botim u mbështet nga:
Projekti: "Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)".
Ky projekt financohet nga Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane dhe zbatohet nga Bashkëpunimi Ndërkombëtar Gjerman (GIZ).

Përgatitur nga:
Ilir Baçi
Blerina Raça

Bashkëpunuan:
Maksim Sinemati, Pranvera Xhelo, Viktor Gumi, Denata Mesi, Sonila Meksi, Rudina Vuksani

Rishikimi gjuhësor:
Dhurata Agalli

Paraqitja Grafike:
Erald Lamja

Shtypi:
Shtypshkronja Kumi

Ky botim është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Europian dhe Qeverisë Gjermane. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e projektit "Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)" dhe në asnjë mënyre nuk mund të interpretohet si opinion i Bashkimit Europian.

This publication has been produced with the assistance of the European Union and the German Government. The contents of this publication are the sole responsibility of the project "Support to the Albanian Ministry of European Integration (SMEI II)" and can in no way be taken to reflect the views of the European Union."

PËRMBAJTJA:

I.	PËRKTHIMI I RREGULLAVE JURIDIKE PËR ATA QË NUK JANË JURISTË	5
1.	HYRJE	7
2.	PASQYRË E SHKURTËR E SISTEMIT JURIDIK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË	9
2.1	AKTET NDËRKOMBËTARE	9
2.2	PROCEDURA E MIRATIMIT TË LIGJEVE TË PROPOZUARA NGA KËSHILLI I MINISTRAVE	11
2.3	STRUKTURA E LIGJIT	12
3.	ÇFARË PËRCAKTOJNË DISPOZITAT JURIDIKE?	14
3.1	DISPOZITAT QË URDHËROJNË (COMMANDS)	14
3.2	DISPOZITAT QË NDALOJNË (PROHIBITIONS)	16
3.3	DISPOZITAT QË LEJOJNË DHE AUTORIZOJNË (PERMISSIONS, AUTHORIZATIONS)	17
3.4	PËRCAKTIMI I DISA TE DREJTAVE	18
3.5	SHPREHJA E PËRKUFIZIMEVE	19
3.6	DISPOZITAT QË SHPJEGOJNË, PËRSHKRUAJNË OSE KONSTATOJNË	19
II.	SHEMBUJ AKTESH SHQIPTARE TË PËRKTHYERA NË GJUHËN ANGLEZE	21
III.	FJALORËT	39
1.	TERMAT QË KANË LIDHJE ME PUSHTETIN PUBLIK	41
1.1	MINISTRITË	41
1.2	NDARJA ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË	41
1.3	VENDET E PUNËS, FUNKSIONET DHE NJËSITË ORGANIZATIVE NË ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE	42
1.4	INSTITUCIONET PUBLIKE	43
2.	TERMA QË KANË LIDHJE ME LEGJISLACIONIN	45
3.	SHPREHJE DHE FORMULIME JURIDIKE	47
4.	TERMAT QE KANE LIDHJE ME BISEDIMET PER ANETARESIM NE BASHKIMIN EUROPIAN	57
IV.	ENGLISH STYLE GUIDE FOR ALBANIAN LEGISLATION	61
1.	SPELLING	63
1.1	CONVENTIONS	63
1.2	CAPITALISATION	64
1.3	HYPHENS AND COMPOUND WORDS	67

2.	PUNCTUATION	69
2.1	FULL STOP	69
2.2	COLON	70
2.3	COMMA	70
2.4	BRACKETS	71
2.5	DASH VS. HYPHEN	71
2.6	QUOTATION MARKS	71
2.7	APOSTROPHE	71
2.8	THE OBLIQUE or SOLDIUS	72
3.	ITALICS	72
4.	NUMBERS	72
4.1.	NUMBERS WRITTEN OUT	72
4.2	FRACTIONS	75
4.3.	INCLUSIVE NUMBERS	75
4.4.	ROMAN NUMERALS	76
4.5.	DATES	76
4.6.	TIME	76
5.	ABBREVIATIONS, ACRONYMS AND SYMBOLS	76
5.1	ABBREVIATIONS AND ACRONYMS	76
5.2	MATHEMATICAL SYMBOLS	78
5.3	SCIENTIFIC SYMBOLS AND UNITS OF MEASUREMENT	78
6.	PERSONAL NAMES AND TITLES	79
7.	GENDER NEUTRAL LANGUAGE	80
8.	GEOGRAPHICAL NAMES	80
9.	SCIENTIFIC NAMES	82
10.	LISTS AND TABLES	83
11.	FOOTNOTES AND ENDNOTES	83
12.	DIAGRAMS	83
13.	VERBS	83
13.1	SPELLING	83
13.2	AGREEMENT	84

**PËRKTHIMI I RREGULLAVE JURIDIKE
PËR ATA QË NUK JANË JURISTË**

1. HYRJE

Ky manual është hartuar për ata që merren me përkthimin e normativave juridike nga gjuha shqipe në atë angleze. Duke qenë se shumica dërrmuese e këtyre personave nuk janë juristë, duhet të vihen në dukje veçantitë kryesore që i dallojnë normat juridike nga tekstet e tjera. Në radhë të parë, përkthyesit duhet të kenë parasysh se tekstet që kërkojnë të përkthejnë në gjuhën angleze janë norma juridike të Republikës së Shqipërisë të cilat kanë fuqi ligjore. Vetë teksti i përkthyer i këtyre normave nuk ka fuqi ligjore, por vetëm qëllim informues, pra, me fjalë të tjera, përkthimi i tyre synon t'i njohë lexuesit e huaj me sistemin juridik shqiptar. Duke pasur parasysh rëndësinë e tyre, përkthimet duhet të jenë të sakta si nga ana gjuhësore, ashtu dhe nga ana juridike. Që përkthyesi ta kuptojë dhe ta përkthejë mirë tekstin burimor, është e nevojshme që ai të zotërojë, të paktën, njohuritë bazë për sistemin juridik shqiptar, për llojet e akteve juridike dhe funksionet e pjesëve të veçanta të tyre, në mënyrë që të transmetojë qartë dhe saktë përmbajtjen juridike në gjuhën angleze.

Manuali synon të shërbejë si një instrument përkthimi që të ndihmojë përkthyesit për përfitim të njohurive bazë, të nevojshme për një punë të suksesshme. Në të ka një numër të madh udhëzimesh dhe shembujsh praktikë të modeleve të përkthimit të disa dispozitave standarde që ua lehtësojnë punën përkthyesve dhe mundësojnë unifikimin e stilit gjatë përkthimit të normave juridike shqiptare në gjuhën angleze. Në këtë tekst të shkurtër nuk është e mundur dhe as nuk synohet të përmenden të gjitha problemet që lindin gjatë përkthimit të normativave juridike. Gjithashtu, fjalori përmban vetëm një numër të vogël termash juridike shqip dhe termash të barasvlershëm me këto të fundit në gjuhën angleze. Termat e barasvlershëm në gjuhën angleze nuk konsiderohen zyrtare, por janë dhënë me synimin për të unifikuar përdorimin e tyre në tekstet e përkthyer nga përkthyes të ndryshëm.

Përkthyesi duhet të bëjë një përkthim "besnik", duke pasur parasysh, në të njëjtën kohë, llojin dhe qëllimin e rregullit juridik që përkthen. Parimi i besnikërisë në përkthimet me karakter juridik sot ndryshon tërësisht nga ai që zbatohet në të kaluarën, kur përkthyesi kishte si detyrë të transmetonte me rigorozitet çdo fjalë të tekstit burimor, madje edhe sintaksën. Kurse tani mbizotëron mendimi se përkthimi duhet t'i qëndrojë besnik përmbajtjes së tekstit burimor, megjithëse përkthyesi ka njëfarë lirie për të krijuar një tekst të "ri" në frymën e gjuhës angleze. Sidoqoftë, liria e përkthyesit është gjithnjë e kufizuar: ai, në radhë të parë, duhet t'i përmbahet në mënyrë rigoroz formës së tekstit burimor dhe të përpiqet që, në përputhje me modelet e përkthimit që jepen në këtë manual, të përdorë formulat standarde, pra ato të terminologjisë të barasvlershme angleze, të sugjeruar për titujt juridikë, shkurtimet, institucionet etj. në gjuhën shqipe. Njëtrajshmëria në përkthimin e termave është një kusht i domosdoshëm në të gjitha përkthimet, sepse çdo njëri prej tyre (termave) është pjesë e të gjithë sistemit juridik shqiptar. Në këto kushte, zgjedhja e termave të barasvlershëm anglezë nuk është e lirë. Në qoftë se një term i barasvlershëm në gjuhën angleze është përcaktuar tashmë për një term, pra për një nocion, të caktuar shqiptar, atëherë ai duhet të përdoret në të gjitha përkthimet në përputhje me rregullin: një term do të thotë një nocion, në qoftë se kjo është e mundur. Nga kjo del se në përkthimet e normave juridike nuk duhet të përdoren sinonimet. Për hir të njëjëtisë, përkthyesi është i detyruar të përdorë termin zyrtar, megjithëse mund të mos jetë dakord me të.¹ Kur nuk ka një term zyrtar dhe as një propozim të tillë, atëherë përparësi kanë termat angleze neutrale. Sigurisht, duhet të shmangen termat juridike angleze të karakterit teknik, me qëllim që të lexuesi i huaj të mos krijohet konfuzion kur bëhet fjalë për nocione të njëjta në legjisllacionin anglo-amerikan. Lexuesi duhet ta ketë gjithnjë të qartë se termat angleze të përkthyer duhet të interpretohen mbi bazën e nocioneve të sistemit juridik shqiptar. Termat shqipe, në përgjithësi, mund të përkthehen fjalë për fjalë, nëse kuptimi i tyre është i qartë në kontekst dhe nëse termi përkatës anglez nuk ka kuptim tjetër teknik në legjisllacionin anglo-amerikan. Por, në praktikë shpesh krijohet keqkuptim, kur përkthyesi përkthen fjalë për fjalë, duke mos e ditur që ekziston termi teknik përkatës në gjuhën angleze.² Për këtë qëllim, vlen të theksohet se përkthyesi

¹ Një shembull i mirë është Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për Titujt". Në këtë ligj, termi 'letra me vlerë' është zëvendësuar me termin 'tituj'. Sigurisht, në një rast të tillë, përkthyesi nuk mund ta përkthejë fjalën "titull" në "title", por "securities".

² Për shembull, 'shoqëri tregtare' nuk përkthehet në 'commercial society' apo 'trade society' por, thjesht, në 'company'. Ose, 'kontabiliteti mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara' përkthehet në anglisht me termin 'accrual accounting'.

e ka për detyrë të konsultohet me materialet ndihmëse të përcaktuara nga Drejtoria e Përkthimit të Legjislacionit pranë Ministrisë së Integrimit Europian dhe, në mungesë të sugjerimeve që duhet të jepnin këta fjalorë, me specialistë të fushës përkatëse të cilët kanë njohuri të mjaftueshme të gjuhës angleze.

Është shumë e rëndësishme që përkthyesi të ketë përvojë, me qëllim që, në mënyrë të pavarur, të mund të vlerësojë se kur, ku dhe në çfarë mase përkthimi mund të jetë i lirë dhe, në të njëjtën kohë, të transmetojë me besnikëri përmbajtjen e tekstit shqip. Në ndryshim nga dispozitat e përgjithshme, kalimtare dhe përmblyëse që përsëriten shpesh dhe kështu në shumicën e tyre janë tipike, dispozitat më të rëndësishme të legjislacionit përmbajnë urdhra, ndalime, lejime dhe autorizime juridike që nuk janë të zakonshme. Duke qenë se çdo sistem juridik ka traditën e vet të teknikës legjislative dhe mënyrën e vet të shprehjeve normative, këto dispozita kryesisht nuk mund të përkthehen me metodat e linguistikës krahasuese, sepse në këtë rast do të mund të kishim pasoja juridike të padëshiruara dhe të padobishme. Kjo do të thotë që përkthyesi duhet të jetë në gjendje të njohë llojet e dispozitave në gjuhën shqipe dhe të formulojë dispozitat përkatëse në gjuhën angleze që do transmetojnë qartë kuadrin juridik përkatës. Për shembull, një nga dallimet bazë mes gjuhëve juridike shqipe dhe angleze është përdorimi i foljes në kohën e tashme në gjuhën shqipe, ndërkohë që në gjuhën angleze përdoret pjesa foljore *shall* që shpreh një formë urdhërore juridike dhe jo kohën e ardhme. Duke pasur parasysh rolin kyç të dispozitave që kanë karakter urdhërues, ndalues, lejues dhe autorizues, ky manual sjell shembuj praktikë të përkthimit të tyre në gjuhën angleze.

Përkthyesi është përgjegjës për saktësinë e përkthimit. Përmbajtja e tekstit burimor duhet të transmetohet gjithnjë në mënyrë objektive, pra duhet të përkthehet “ajo që është thënë” dhe jo ajo që përkthyesi mendon se “duhej të ishte thënë”. Në rastin kur teksti shqip është i paqartë në kuptimin e tij, atëherë përkthyesi ka për detyrë të kërkojë interpretimin zyrtar. Nëse edhe ky i fundit nuk e sqaron çështjen, atëherë duhet të ruhet dykuptimësia, pra paqartësia në versionin e përkthyer. Përkthyesi duhet të synojë njëvlershmërinë, qartësinë dhe saktësinë dhe madje, nëse është e nevojshme, mund të ndryshojë radhën e fjalëve ose të përdorë konstrukcione sintaksore të tjera, specifike për gjuhën juridike angleze, nëse është e nevojshme. Parimisht sintaksa mund të ndryshohet që përkthimi të jetë në frymën e gjuhës angleze, por vetëm nëse kuptimi dhe raporti logjiko-semantik mbeten të pandryshuar. Një vëmendje të veçantë duhet t’i kushtohet shprehjes së mohimit, për më tepër që gjuha angleze nuk mund të lejojë një numër të madh mohimesh në fjali, kështu që një gjë e tillë mund ta bëjë dispozitën të pakuptueshme ose madje t’i ndryshojë kuptimin. Po ashtu rekomandohet që përkthyesi të mos i shndërrtojë dispozitat negative në pozitive dhe anasjelltas, sidomos kur është fjala për dispozita që përcaktojnë barrën e provës ose faktet që duhet të konfirmohen. Pra, vlen të theksohet se sintaksa mund të ndryshohet, me qëllim që përkthimi të bëhet sa më i kuptueshëm dhe më i qartë.

Ky synim për të përçuar qartësi duhet të realizohet duke shmangur përdorimin e fjalëve zëvendësuese në normat juridike, kështu që kryefjala mund të përsëritet shumë herë më tepër sesa ndodh zakonisht në gjuhën e përditshme. Gjithashtu duhet të kihet parasysh se emrat që në gjuhën shqipe janë në njëjës dhe që nuk e përcaktojnë saktë ndonjë person ose objekt të caktuar, shpesh përkthehen në gjuhën angleze në shumës. Kështu, nevojitet një përvojë e madhe që të përdoret saktë dhe drejt pjesëza e trajtës së shquar *the* në përkthimin në gjuhën angleze. Në fund, duhet të theksohet se përkthyesi nuk ka liri veprimi kur teksti burimor përmban ndonjë citat (referim) të marrë nga një tjetër rregull shqiptar, i cili tashmë është përkthyer. Në këtë rast, përkthyesi ka për detyrë të përdorë përkthimin ekzistues anglisht të tekstit të cituar, qoftë edhe sikur të jetë fjala vetëm për një dispozitë. Kështu duhet vepruar edhe në rastin e emërimit të ligjeve, rregulloreve, vendimeve etj. shqiptare që tashmë janë përkthyer në gjuhën angleze. Pas korigjimit të tyre përfundimtar, të gjitha përkthimet vendosen në internet dhe kështu përkthyesit i lehtësohet puna, nëse ka nevojë për citime, duke e ndihmuar atë për të siguruar konsekuencë gjatë zgjedhjes së termave të barasvlershëm në gjuhën angleze.

2. PASQYRË E SHKURTËR E SISTEMIT JURIDIK TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Hierarkia e legjislacionit shqiptar parashikohet në nenin 4 dhe nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në bazë të tyre, normat ligjore në Republikën e Shqipërisë parashikohen në aktet normative të mëposhtme, të cilat kanë fuqi ligjore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë:

- a. Kushtetuta;
- b. marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
- c. ligjet;
- ç. aktet normative të Këshillit të Ministrave.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	Constitution of the Republic of Albania
Marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara	Ratified International Treaties
Ligj	Law
Akt normativ i Këshillit të Ministrave	Regulation
Vendim i Këshillit të Ministrave	Council of Ministers' Decree

2.1 AKTET NDËRKOMBËTARE

Shqip	English
AKTET NDËRKOMBËTARE	INTERNATIONAL ACTS
Traktat	Treaty
Marrëveshje	Agreement
Marrëveshje kuadër	Framework Agreement
Konventë	Convention
Kartë	Charter
Protokoll	Protocol
Deklaratë	Declaration/Statement
Memorandum Mirëkuptimi	Memorandum of Understanding

Kuti shpjeguese: Cilat janë aktet ndërkombëtare?

Traktati

Për nga kuptimi i përgjithshëm, traktati është një nocion që i mbulon të gjitha llojet e akteve ndërkombëtare me karakter obligues, të arritur në parim në formë të shkruar mes subjekteve ndërkombëtare. Për nga kuptimi i veçantë, traktati nënkupton zakonisht aktet ndërkombëtare “më të rëndësishme”, si për shembull traktatet për paqen, për kufijtë, për miqësinë, për tregtinë e lirë dhe për bashkëpunimin, etj. Në praktikën ndërkombëtare ky term po zëvendësohet gjithnjë e më shumë me terma të tjera.

Marrëveshja

Për nga kuptimi i përgjithshëm, *marrëveshja* është një nocion që i mbulon të gjitha llojet e akteve ndërkombëtare të cilat nuk e përmbushin përkufizimin e traktatit. Për nga kuptimi i veçantë, marrëveshja, në parim, është një akt zyrtar i një niveli më të ulët që rregullon fushat e ngushta të traktatit. Ekziston një tendencë e përgjithshme e përdorimit të termit marrëveshje për traktatet dypalëshe ose shumëpalëshe të kufizuara. Integrimi rajonal ndërkombëtar mbështetet në marrëveshje kuadër të përgjithshme të karakterit juridiko-kushtetues. Ndryshimet dhe plotësimet në këto marrëveshje, si për shembull në rastin e pranimit të shteteve anëtare të tjera, gjithashtu quhen marrëveshje. Aktet që nënshkruhen brenda kuadrit të një marrëveshjeje të karakterit juridiko-kushtetues ose nga organet e institucioneve rajonale quhen zakonisht marrëveshje, në mënyrë që të dallohen nga traktatet bazë (për shembull Traktati i Parisit, Traktati i Romës, Traktati i Amsterdimit, por themi Marrëveshja për Stabilizimin dhe Asociimin mes Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian).

Konventa

Për nga kuptimi i përgjithshëm, *konventa* është një nocion që i mbulon burimet e së drejtës që nuk janë ligje ndërkombëtare, porime të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, terma juridike ndërkombëtare ose analiza shkencore dhe didaktike. Përdorimi i termit konventë përfshin të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare kështu që në këtë kuptim ky term është i njëjtë me termin traktat. Për nga kuptimi i veçantë, konventa në të kaluarën është përdorur rregullisht për marrëveshjet dypalëshe, kurse sot shërben për traktatet shumëpalëshe zyrtare me një numër më të madh palësh. Konventat zakonisht janë të hapura ndaj të gjithë bashkësisë ndërkombëtare ose numrit më të madh të shteteve. Në shumç raste, marrëveshjet që arrihen nën kujdestarinë e organeve të organizatave ndërkombëtare ose që i kanë miratuar ato, quhen konventa.

Karta

Termi *kartë* nënkupton në mënyrë të veçantë një akt zyrtar dhe formal, për shembull traktati që rregullon një organizatë ndërkombëtare (Karta e Kombeve të Bashkuara, etj.).

Protokolli

Termi *Protokoll* nënkupton akte zyrtare të nivelit më të ulët sesa ato që quhen traktate ose konventa. Ky nocion mbulon një sërë aktesh ndërkombëtare, siç janë aktet që rregullojnë interpretimin e dispozitave bazë që janë rregulluar me traktat, aktet që përmbajnë dispozita zyrtare që nuk janë përfshirë në kuadrin e traktatit ose akte që rregullojnë çështje teknike dhe të zbatimit të dispozitave të vetë traktatit. Gjithashtu, ndonjëherë protokolle quhen edhe ato akte me të cilat plotësohen ose ndryshohen akte të tjera.


Deklarata

Deklaratë quhen aktet ndërkombëtare të ndryshme që në shumë raste shprehin vullnetin e palëve për akte të natyrës jo obliguese. Megjithatë, deklaratat mund të jenë traktate obliguese, pra karakteri obligues i dispozitave duhet të përcaktohet sipas çdo rasti të veçantë të deklaratës. Deklarata, për shembull, janë aktet e përfshira në traktat për hir të interpretimit ose të argumentimit të dispozitave të traktateve, akte të natyrës jo zyrtare për çështje më pak të rëndësishme etj.

Memorandumi i Mirëkuptimit

Termi *Memorandum Mirëkuptimi* nënkupton akte ndërkombëtare të natyrës më pak zyrtare. Në shpesh raste, ai përdoret për përcaktimin e rregullave operative, duke u mbështetur te marrëveshja kuadër përkatëse ndërkombëtare, por edhe për përcaktimin e çështjeve teknike ose të specializuara të ngushta.

2.1 PROCEDURA E MIRATIMIT TË LIGJEVE TË PROPOZUARA NGA KËSHILLI I MINISTRAVE



2.3 STRUKTURA E LIGJIT

Ndarjet strukturore të ligjit në rend zbritës janë:

1. pjesët
2. titujt
3. krerët
4. seksionet

Struktura-bazë e një teksti ligjor është neni.

Pjesët përbërëse të një neni në rend zbritës janë:

1. numri i nenet
2. paragrafi
3. nënparagrafi
4. nën-nënparagrafi

Pjesët: Këto përdoren zakonisht në rastin e ligjeve më voluminoze, siç janë Kushtetuta ose kodet.

Titujt: Mund të jetë e nevojshme që pjesët e një ligji të ndahen në tituj, për shembull, në rastin e Kodit Civil. Pjesa I është ndarë në "Titulli I", i cili parashikon subjektet e së drejtës civile; "Titulli II", i cili parashikon institutin e përfaqësimit; "Titulli III", që rregullon veprimet juridike etj.

Kreu: Kur kemi ligje të gjata, që përmbajnë më shumë se 15-20 nene. Mënyra më e mirë e organizimit të tyre është bashkimi i neneve me objekte të njëjta, në krerë.

Seksionet: Nenet e një kreu, që kanë objekt të njëjtë, mund të grupohen në seksione.

Tabela XX: Përkthimi anglisht i pjesëve përbërëse të ligjeve

shqip	anglisht
LIGJ	LAW
PJESA	PART
TITULLI	TITLE
KREU	CHAPTER
SEKSIONI	SECTION
Neni	Article
Paragrafi/Pika	Paragraph
Nënparagrafi/Germa	Subparagraph/Point/Indent

Shënim: Gjatë përkthimit të paragrafëve dhe nënparagrafëve duhet ruajtur sistemi i renditjes që është përdorur në versionin shqip. Kur pikat janë renditur me shkronja (a, b, c, ç, d, dh,...) i njëjti sistem duhet përdorur edhe në anglisht, pavarësisht se këto shkronja i mungojnë alfabetit anglez, pra (a, b, c, ç, d, dh,...)

LIGJ¹
PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE

.....
 PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Pjesa/Part

TITULLI I

DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR TREGTARIN
 DHE SHOQËRITË TREGTARE

Titulli/Title

.....

Neni 73

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

Neni/Article

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

Pika/Paragraph

.....

LIGJ²

PËR TITUJT

.....
 PJESA E PARË

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Kreu/Chapter

.....

KREU III

LLOJET E TITUJVE

.....

Seksioni I

Aksionet

Seksion/Section

Neni 30

Miratimi i prospektit

Prospekti, përpara publikimit ose dorëzimit të tij tek investitorët e mundshëm, paraqitet për miratim pranë Autoritetit. Emetuesi, së bashku me kërkesën për miratimin e prospektit, paraqet prospektin, vendimin për emetimin e titujve, si dhe çdo dokumentacion tjetër, të parashikuar nga ky ligj apo që i kërkohet nga Autoriteti.

Paragrafi 1/Paragraph 1

Prospekti publikohet dhe u jepet investitorëve të mundshëm, vetëm pasi ai të miratohet nga Autoriteti.

Paragrafi 2/Paragraph 2

¹ Nr.9901, datë 14.04.2008

² Nr.9879, datë 21.02.2008

3. ÇFARË PËRCAKTOJNË DISPOZITAT JURIDIKE?

Legjislacioni përmban norma juridike që në parim shprehen dhe hartohen me anë të shumë dispozitave. Dispozita juridike, në shumë raste, është hipotetike, çka do të thotë se raporti mes kryefjalës dhe kundrinorit kushtëzohet nga diçka. Dispozita hipotetike përbëhet nga kushti dhe pasoja. Dispozita hipotetike, në shumë raste, shprehet me fjali kushtore, në të cilën hipoteza ndodhet në fjalinë e varur, ndërsa pasoja në fjalinë kryesore, kështu që raporti bazë logjiko-semantik gjen vend qartë të shprehja :“në qoftë se x, atëherë duhet y”. Pra, për shembull, nëse është shkaktuar dëm, ai që e ka shkaktuar dëmin duhet të paguajë dëmshpërblim. Ekzistojnë shumë mënyra për shprehjen e dispozitave hipotetike të së njëjtës përmbajtje. Për shembull, personi që shkakton dëmin, është i detyruar të paguajë dëmshpërblim.

Shembull 1: Neni 5 i Ligjit nr. 9880 “Për nënshkrimin elektronik”

Nëse transaksioni ligjor është një kontratë atëherë secila prej palëve duhet të nënshkruajë të njëjtin dokument me nënshkrimet elektronike të kualifikuara përkatëse.	If the legal transaction is a contract then each party shall sign the same document with its respective qualified electronic signature.
---	---

Normat juridike ose dispozitat kanë një funksion normativ të përgjithshëm, megjithëse në to ka jo vetëm shprehje normative, por edhe shprehje të tjera treguese dhe përshkruese. Pjesa më e rëndësishme e dispozitës është përmbajtja normative e saj, sepse këtu përcaktohen detyrimet në formën e urdhrave dhe të ndalimeve, si dhe lejet, kompetencat dhe të drejtat. Veç kësaj, ka edhe dispozita që japin përkufizime dhe dispozita që përshkruajnë ndonjë gjendje faktike ose konstatojnë ekzistencën e disa entiteteve, sikurse janë shtetet, organet administrative, etj. Megjithatë, shumica e dispozitave janë norma sjelljeje që urdhërojnë një subjekt të caktuar të bëjë diçka (URDHRI), apo që ia ndalojnë një subjekti të caktuar të bëjë diçka (NDALIMI), apo që e lejojnë një subjekt të caktuar të bëjë diçka (LEJA) ose e autorizojnë një subjekt të caktuar të bëjë diçka (AUTORIZIMI). Për shprehjen e përmbajtjes normative, rol kyç ka folja kryesore e saj.

Gjatë përkthimit të rregullave juridike nga gjuha shqipe në atë angleze, përkthyesi duhet të dallojë, në radhë të parë, se për cilën lloj dispozite bëhet fjalë, dhe, më pas, të formojë anglisht dispozitën përkatëse, e cila do të paraqiste pasojën juridike të dëshiruar. Mirëpo, një dispozitë e caktuar nuk shprehet medoemos në të njëjtën mënyrë në sisteme juridike të ndryshme, kështu që përkthyesi nuk duhet t'i përkthejë rregullat juridike sipas metodave të lingistikës krahasuese. Pra, ai ka për detyrë të mësojë t'i formulojë urdhrat (commands), ndalimet (prohibitions), lejet (permissions), autorizimet (authorizations), të drejtat (rights), përkufizimet (definitions) dhe dispozitat me karakter deklarativ në përputhje me rregullat e gjuhës angleze që ekzistojnë në teknikën legjislative anglo-amerikane ose në teknikën legjislative të Bashkimit Evropian. Në vijim, jepen shpjegime lidhur me përkthimin e llojeve kryesore të dispozitave ligjore.

3.1 DISPOZITAT QË URDHËROJNË (COMMANDS)

Vështirësitë më të mëdha shfaqen gjatë përkthimit të dispozitave që e imponojnë detyrimin në formën e urdhrit, sepse në gjuhën juridike shqiptare shpesh përdoret koha e tashme, ndërsa në atë angleze përdoret folja ndihmëse shall. Duhet të kuptohet se kjo nuk shpreh kohën e ardhshme, por një mënyrë “urdhërore juridike”, e cila, në gjuhën angleze, do të mund të shprehej ndryshe “has a duty to”. Gjithashtu, duhet të theksohet menjëherë se shall përdoret vetëm në pjesën vendimore të dispozitës dhe asnjëherë në hipotezë (shih Shembullin 1). Shprehja e urdhrave me ndihmën e foljes ndihmëse shall është traditë në gjuhën juridike angleze dhe fillimet e mesjetës, kur është përkthyer e drejta romake. Me ndërmarrjen, kohët e fundit, të nismave “Plain English”, “Clarity” dhe “Fight the Fog”, në Bashkimin Evropian po bëhen përpjekje që gjuha legjislative të bëhet më e kuptueshme për njeriun e zakonshëm, kështu që, midis të tjerave, është propozuar që në vend të shall të përdoret must për shprehjen e imperativit në rregullat juridike. Megjithatë, deri tani ky propozim nuk është pranuar gjerësisht në teknikën legjislative të shteteve që i përkasin sistemit juridik anglo-amerikan. Për më tepër, korrektorët juridikë në Bashkimin Evropian

vazhdojnë t'i përmbahen parimit të përdorimit të foljes ndihmëse shall në gjuhën angleze në dispozitat e pjesës qendrore të të gjitha akteve juridike detyruese, si dhe të përdorimit të kohës së tashme në gjuhën franceze. Përdorimi i kohës së tashme në vend të mënyrës urdhërore për shprehjen e një qëndrimi përshkrues është praktikë e zakonshme në shumë sisteme juridike kontinentale, po ashtu edhe në Shqipëri, sikurse duket kjo edhe nga këta shembuj:

Shembull 2: Neni 6, Ligji nr. 10236, dt. 18.2.2010, "Për marrjen në kontroll të shoqërive publike"

Përpara se të bëjë ofertën e marrjes në kontroll, ofruesi njofton me shkrim Autoritetin dhe administratorët e shoqërisë, objekt i ofertës.	Before the takeover bid, the offeror shall notify the Authority and the management of the offeree company in writing.
--	---

Shembull 3: Neni 13, pika 1, ligji nr. 9952, dt. 14.7.2008, "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it"

Institucionet shtetërore përgjegjëse e organizatat jofitimprurëse përgatisin dhe e shpërndajnë informacionin, si dhe realizojnë edukimin dhe komunikimin, për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it, në përputhje me pikën 2 të nenit 10 të këtij ligji.	Responsible state institutions and non-profit organizations shall prepare and propagate information and carry out education and communication activities on preventing and controlling HIV/AIDS in accordance with Article 10 (2) of this Law.
--	--

Shprehja e detyrimit me ndihmën e pjesës foljore shall bën të ditur qartë se fjala është për një dispozitë me karakter detyrues. Kjo do të thotë se subjekti, me të cilin ka të bëjë dispozita, duhet të bëjë ose t'i japë diçka një subjekti tjetër; pra nuk ka asnjë paqartësi lidhur me sjelljen në një situatë të tillë. Mosrespektimi ose shkelja e saj sjell si pasojë vendosjen e sanksioneve, si edhe bërjen të pavlefshme të një akti, dokumenti ose veprimi juridik. Kur detyrimi shprehet në formë dëftore tipike të kohës së tashme, ekziston rreziku që kuptimi përshkrues i dispozitave të mos gjejë shprehje, nëse nuk kuptohet nga konteksti. Për këtë arsye, në raste të tilla, ligjvënësi shqiptar përdor shprehje të tilla foljore si "ka për detyrë" ose "duhet".

Shembull 4: Neni 11, ligji nr. 9952, dt. 14.7.2008, "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it"

Informimi, edukimi dhe komunikimi për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it duhet të përmbajnë të dhëna për:	Information, education and communication for preventing and controlling HIV/AIDS shall include:
--	---

Shembull 5: Neni 74, pika 1, Ligji nr. 9154, dt. 06.11.2003, "Për arkivat"

Shërbimi arkivor dhe autoritetet publike krijuese të dokumenteve janë të detyruara:	The Archive Service and public authorities generating any documents shall:
---	--

Vlen të përmendet se Joint Practical Guide e Bashkimit Evropian rekomandon shmangien e përdorimit të kohës së ardhshme në dispozitat juridike në gjuhët angleze dhe franceze atëherë kur kjo është e mundur. E njëjta gjë vlen, si rregull, edhe për normat juridike shqipe, sepse ligjet kanë funksion ekstratemoran (jo-kohor).

Duhet të theksohet se folja ndihmëse angleze should nuk ka kuptim përshkrues dhe, për këtë arsye, nuk përdoret kurrë në dispozitat detyruese. Në rregullat dhe direktivat europiane fjala should përdoret vetëm në preambula dhe kjo në kuptimin "rekomandohet".

Në ndryshim nga kërkohet, përdorimi i foljes modale duhet bën të qartë se mospërmbushja e detyrimit e bën të pavlefshëm aktin, dokumentin ose procedurën përkatëse. Kur dispozita shqip formulohet me duhet, përkthyesi mund të përdorë shall ose must, por megjithatë përparësi ka must. Si rregull, folja ndihmëse must

përdoret për shprehjen e dispozitave, në të cilat ekzekutuesi i veprimit as nuk përmendet dhe as nuk dihet nga konteksti, pra kryesisht në fjalitë vetvetore (apo, passive voice në anglisht). Must gjithashtu përdoret në dispozitat që kërkojnë plotësimin ose përmbushjen e disa kushteve, ndërsa subjekti nuk është qenie e gjallë:

Shembull 6: Neni 17, pika 4, Ligji nr. 10236, dt. 18.2.2010 "Për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike"

Shuma minimale e dëmshpërblimit duhet të përcaktohet në dokumentet e themelimit të shoqërisë, objekt i ofertës, dhe nuk duhet të tejkalojë vlerën e kapitalit të kësaj shoqërie shumëzuar me numrin e të drejtave të votës, që kanë aksionet me përparësi.	The minimum amount of compensation must be specified in the acts of association of the offeree company and must not be bigger than the capital of the company multiplied by the number of voting rights assigned to preferential shares.
--	--

Sot nuk ka qëndrim unik për përdorimin e foljes ndihmëse *must* në rregullat juridike në gjuhën angleze. Ndërsa mbështetësit e nismës "Plain English" shprehen në favor të përdorimit të foljes *must* në vend të *shall* në të gjitha dispozitat detyruese, juristët e sistemit juridik anglo-amerikan, në shumicën e tyre, janë kundër këtij përdorimi. Sikurse është thënë tashmë, redaktorët juridikë të Bashkimit Evropian e kanë kundërshtuar propozimin për përdorimin e përgjithshëm të foljes *must*. Përgjithësisht, mund të themi se *must* përdoret në ato dispozita detyruese, në të cilat kërkohet që të përmbushet ose të plotësohet diçka, me qëllim që të prodhohë pasoja juridike. Në tekniken legjislativë anglo-amerikane dispozita të tilla quhen *requirements*, ndërkohë që në gjuhën shqipe nuk bëhet dallim mes *commands* dhe *requirements*, por flitet përgjithësisht për kërkesa ligjore me karakter urdhëruar. Duke pasur parasysh përmbajtjen, nuk është gjithnjë e lehtë të vendoset nëse duhet të përdoret *must* apo *shall*, sepse janë të mundshme rastet kufizuese, sidomos kur është fjala për formalitete procedurale. Në dispozitën pasardhëse, fjalia e parë përcakton natyrën detyruese të procedurës, kurse fjalia tjetër përcakton kushtin që duhet të përmbushet në mënyrë që vendimi të jetë i vlefshëm.

Save as otherwise provided in this Statute, decisions of the Board of Governors shall be taken by a majority of its members. This majority must represent at least 50% of the subscribed capital. (Pika 1 e Nenit 8 "Protokolli për Statutin e Bankës Europiane të Investimeve", Traktatit Themelues i Kushtetutës së Europës).

Sidoqoftë, përdorimi i foljes *must* në përkthim kërkon kujdes. Nëse përkthyesi nuk është i sigurt, duhet të përdorë *shall* në vend të *must*, sepse *shall* mund të përdoret në vend të *must*, ndërsa ende nuk është pranuar gjerësisht që *must* mund ta zëvendësojë gjithnjë *shall*. Duhet të theksohet se koha e tashme përdoret edhe në gjuhën angleze për shprehjen e detyrimeve procedurale në aktet nënligjore, për shembull "*The candidate signs the application*".

3.2 DISPOZITAT QË NDALOJNË (PROHIBITIONS)

Ndalimi është një detyrim negativ që ndalon qartë një subjekt të caktuar të bëjë diçka. Pra, kërkon që një subjekt i caktuar të mos kryejë një veprimtari të caktuar, sepse, në rast të kundërt, mund të paditet, pra të akuzohet dhe të sanksionohet. Për shprehjen e detyrimit për moskryerjen e një veprimtarie të caktuar ("nuk duhet"), më shpesh përdoret forma negative e mënyrës urdhërore *shall not* ose "asnjë person nuk" (për shembull "*No person shall...*") (Kujdes përdorimin e mohimit të dyfishtë!). Kur thuhet qartë se diçka ndalohet ("ndalohet", "është e ndaluar"), kjo përkthehet "*it is prohibited*".

Shembull 7: Pika 1, Neni 32 i Kodit të Familjes dhe Legjisllacionit për Birësimet së Shqipërisë

Asnjëri nuk duhet të nxjerrë përfitime të parregullta financiare ose përfitime të tjera nga veprimtari që lidhen me birësimin jashtë vendit.	No person shall make any unlawful financial gains or any other gains from adoptions abroad.
--	---

Shembull 8: Neni 13 i Kodit të Familjes dhe Legjislacionit për Birësimet së Shqipërisë

Ndalohet martesë midis kujdestarit dhe dhe personit që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria.	Guardians shall not marry their wards during the term of guardianship.
--	--

Dispozita, me anën e së cilës hiqet një kompetencë, leje ose e drejtë e caktuar, gjithashtu përbën ndalim që shprehet me “nuk mund” ose “nuk lejohet”, pra “*may not*” në anglisht. Dispozita analoge përcaktojnë se një subjekt ose pushtet publik i caktuar nuk ka kompetencë, leje ose të drejtë të bëjë diçka:

Shembull 9: Neni 12, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Personi nuk mund të ketë njëkohësisht më shumë se një vendbanim.	A person may not have more than one place of residence at any time.
--	---

Shembull 10: Pika 2, Neni 4, Ligji Nr.10 273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”

Marrësi, i cili ka pranuar përdorimin dhe qarkullimin e dokumentit elektronik, nuk mund të refuzojë dokumentin elektronik në mënyrë të njëanshme, vetëm për faktin që ai është përgatitur, përdorur dhe qarkulluar në formë elektronike.	Addressees who have recognized the use and circulation of electronic documents may not refuse any electronic documents unilaterally based on the ground that such documents have been prepared, used and circulated electronically.
--	---

Për mohimin e detyrimit të përmbushjes në gjuhën shqipe përdoret “nuk është nevoja” ose “nuk duhet”, ndërsa në gjuhën angleze “need not” ose “no person must”:

Shembull 11: Pika 1, Neni 25, Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”

Subjektet nuk duhet ta përdorin sekretin profesional ose përfitimet prej tij si arsye për mosrespektimin e detyrimeve, që rrjedhin nga ky ligj, kur kërkohet informacion ose kur, në përputhje me këtë ligj, urdhërohet nxjerrja e një dokumenti, që ka lidhje me informacionin.	Subjects must not use any professional secrets or any benefits thereof as reasons for noncompliance with this Law if information is requested or if, in accordance with this Law, the production of any documents in relation to such information is ordered.
--	---

3.3 DISPOZITAT QË LEJOJNË DHE AUTORIZOJNË (PERMISSIONS, AUTHORIZATIONS)

Lejimi shpreh diçka që lejohet qartë, pra diçka që nuk ndalohet. Shpesh përdoret për shprehjen e përjashtimit nga rregullat e përgjithshme të përcaktuara që urdhërojnë ose ndalojnë. Në qoftë se një veprimtari e caktuar lejohet, kjo do të thotë se subjekti, me të cilin ka lidhje dispozita, mund ta kryejë këtë veprimtari të caktuar, por edhe mund të mos e kryejë. Pra, dispozita nuk është detyruese. Sa i përket autorizimit (pra, kompetencës), organi ose personi i autorizuar e kryen një veprimtari të caktuar, sepse për këtë është i autorizuar me ligj dhe kryerja e veprimtarisë, në shpesh raste, konsiderohet e detyrueshme. Hera herës është e vështirë të dallohet lejimi nga autorizimi, por kjo nuk përbën ndonjë problem për përkthyesin, sepse, megjithëse funksionet e tyre janë të ndryshme, në gjuhën angleze përdoret kryesisht *may* për shprehjen e lejimit ose të autorizimit. Lejimi në gjuhën shqipe shprehet me “mund”, “lejohet” ose “është e lejuar”. Në dispozitat procedurale shprehja “është e lejuar” përkthehet “it is admissible”, ndërsa shprehjet “it is permitted” dhe “it is allowed” nuk përdoren në normat juridike në gjuhën angleze. Autorizimi në normat në gjuhën shqipe shprehet me fjalët “është i autorizuar” ose “mund”. Për shprehjen e autorizimit në gjuhën angleze, krahas foljes modale *may*, përdoren edhe shprehjet “is authorised to”, “is empowered to”, si dhe “has the power to”. Në

qoftë se autorizimi është i detyrueshëm, pra nëse kërkon një veprimtari të caktuar, përkthyesi duhet të përdorë foljen modale *shall*, për të cilën kemi folur më lart në këtë material, kur diskutuam për dispozitat përshkruese ose detyruese.

Shembull 12: Pika 1, Neni 4, Ligji Nr.10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”

1. Gjuajtja e individëve të llojeve të ndaluara, përjashtimisht, mund të bëhet në rastet:	1. As a derogation, individuals from prohibited species may be hunted in the following cases:
---	---

Shembull 13: Pika 2, Neni 5, Ligji Nr. 10 216, datë 21.1.2010 “Për detergjentët”

Aplikuesi mund të kërkojë rishikimin e aplikimit për përjashtim pasi ka plotësuar kërkesat e përcaktuara sipas këtij ligji. Mbi bazën e informacionit të siguruar nëpërmjet dosjes teknike të rishikuar, ministria mund të marrë vendimin për ta zgjatur, modifikuar ose hequr përjashtimin.	Applicants may apply for a revision of their applications for exemption after they have complied with the requirements of this Law. Basen on the information contained in the revised technical file, the Ministry may take a decision to extend, modify or revoke an exemption.
--	--

Shembull 14: Pika 2, Neni 20, Ligji Nr.10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”

2. Veprimtaria e vetme e një shoqërie administruese është administrimi i fondit të pensionit. Autoriteti mund të lejojë dhe të nxjerrë rregullore për kushtet, që duhet të përmbushë shoqëria administruese, në mënyrë që të kryejë veprimtari, të cilat janë të lidhura ngushtë me administrimin e fondit të pensionit, si administrimi i fondeve të investimeve dhe administrimi i asetëve, me kusht që shoqëria administruese të jetë e pajisur me licencën e duhur, për të kryer këto lloje veprimtarish.	2. The only activity a management company shall undertake is the management of pension funds. The Authority is authorized permit and issue regulations on the conditions a management company has to meet to also undertake activities that are closely related to pension fund management, such as the management of investment funds and asset management, provided the management company obtains the appropriate license to conduct such activities.
---	--

3.4 PËRCAKTIMI I DISA TË DREJTAVE

Të drejtat dhe liritë bazë që janë të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe shprehen në formën e urdhrave që e detyrojnë shtetin të ofrojë mbrojtjen e caktuar (“Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare.” / “The Republic of Albania shall protect the rights of its citizens with a temporary or permanent residence outside its borders.” Neni 8, Pika 2, e Kushtetutës) dhe në formën e ndalimeve që e detyrojnë shtetin të mos kryejë veprimtari ose veprime të caktuara (“Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.” / “Prior censorship of the media is prohibited.” Neni 22, Pika 3, e Kushtetutës). Megjithatë, më shpesh të drejtat përcaktohen në dispozita me anë të shprehjes treguese “ka të drejtë”, pra “has the right to” (“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.” / “Everyone has the right, in compliance with the law, to get information about the activity of state bodies, as well as of persons who exercise state functions.” Neni 23 i Kushtetutës). Në norma juridike të tjera, një formë tjetër e shpeshtë për përcaktimin e disa të drejtave në gjuhën shqipe është edhe “ka të drejtë”, ndërsa në gjuhën angleze përdoren “has the right to”, “is entitled to” ose madje “may”.

Shembulli 15: Pika 1, Neni 6 i Kodit të Procedurës Penale

I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat.	Defendants have the right to self-representation or assistance of defence counsels. If they have insufficient means they are entitled to free legal aid.
---	--

3.5 SHPREHJA E PËRKUFIZIMEVE

Dispozitat që përcaktojnë kuptimin e nocioneve juridike, domethënë përkufizimet ligjore, kanë funksion përshkrues, po të kemi parasysh se autori i përkufizimit normativ krijon kuptime të reja që kanë natyrë detyruese zyrtare. Për këtë arsye, në normat juridike në gjuhën angleze përkufizimet janë shprehur rregullisht me përdorimin e foljes ndihmëse *shall*. Megjithatë, sot për formulimin e përkufizimit, gjithnjë e më shumë, po përdoret koha e tashme si në gjuhën shqipe, ashtu dhe në atë angleze, për shembull: “Termet në këtë Ligj kanë kuptimin e mëposhtëm:”/ “For the purpose of this Law, the following terms mean:”. Për përcaktimin e pjesëve të veçanta të një nocioni ose të elementeve të veçanta të një gjendjeje faktike, pra të kriterit për ekzistencën e një gjendjeje të caktuar, shpesh në gjuhën juridike përdoret “konsiderohet”, pra “is deemed to be”:

Shembull 16: Germa “a”, Neni 3 i Ligjit Nr. 10 263, datë 8.4.2010, “Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”

“Tokë bujqësore” ka kuptimin e përcaktuar në pikën 3 të nenit 2 të ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”	“Agricultural land” has the meaning specified in Article 2 (3) of Law No. 9244 of 17 June 2004 “On the Protection of Agricultural Land”
--	---

Shembull 17: Paragrafi 4 i Aneksit 1 të Ligjit Nr.9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve bio”

Mbledhja e bimëve dhe pjesëve të ngrënshme, që rriten në mënyrë natyrale në zona natyrale, pyje dhe zona bujqësore, konsiderohet metodë e prodhimit organik me kusht që:	The harvesting of edible parts and plants which grow naturally in natural areas, forests and agricultural land is deemed to be a method of organic production provided that:
--	--

3.6 DISPOZITAT QË SHPJEGOJNË, PËRSHKRUAJNË OSE KONSTATOJNË

Në normat juridike qëndrimet orientuese dhe përshkruese gërshetohen dhe plotësohen në mënyrë të ndërsjellë. Kështu, ka dispozita të tilla që kanë funksion përshkrues dhe konstatues. Këto dispozita, kryesisht, përshkruajnë një gjendje faktike të caktuar ose konstatojnë ekzistencën e subjekteve, sikurse janë të tilla shtetet, organet administrative, etj. Kuptimi i këtyre qëndrimeve shprehet me anë të pjesëve të foljes me qenë dhe të foljeve që e zëvendësojnë atë, *me ekzistuar, me u ndodhur, me pasur*, etj. Ndërsa më parë në dispozita të tilla, kryesisht, përdorej shall në gjuhën angleze, sot në to, gjithnjë e më shumë, përdoret koha e tashme. Për shembull, në dispozitat për krijimin e një subjekti ose organi në rregullat juridike të mëparshme përdorej “There shall be...”, kurse sot përdoret “There is hereby established...” (psh.: “There is hereby established a corporation” në vend të “There shall be a corporation”).

Megjithatë, përkthyesi duhet të ketë kujdes. Për shembull, “Nuk ka dënim me vdekje” duhet të përkthet “There shall be no death penalty”, sepse kjo përbën ndalim. Sot përdorimi i kohës së tashme është pranuar gjerësisht edhe për formulimin e dispozitave që përcaktojnë fushat e zbatimit të një ligji të caktuar, kështu “*This Law applies*” në vend të “*This Law shall apply*”.

Shembull 18: Pika 1, Neni 1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Shqipëria është republikë parlamentare.	Albania is a parliamentary republic.
---	--------------------------------------

**SHEMBUJ AKTESH SHQIPTARE
TË PËRKTHYERA NË GJUHËN ANGLEZE**

L I G J
Nr.9062, datë 08.05.2003

KODI I FAMILJES

Në mbështetje të neneve 53, 54, 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Martesa, si një bashkëjetesë ligjore, mbështetet në bazën morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje. Martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit.

Neni 2

Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 3

Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesa ose jashtë martese.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes.

Neni 4

Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesa.

Neni 5

Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

Neni 6

Në çdo procedurë që i përket të miturit, ai ka të drejtë të dëgjohet, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, duke ruajtur të drejtën që i japin dispozitat e veçanta që garantojnë ndërhyrjen dhe dhënien e pëlqimit nga ana e tij.

Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij nuk mund të rrëzohet, veçse

LAW
No. 9062 of 8 May 2003

FAMILY CODE

Pursuant to Articles 53, 54, 81 and 83 (1) of the Constitution of the Republic of Albania, upon the Council of Ministers' proposal,

THE PARLIAMENT
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

D E C I D E D:

PART I
General Principles

Article 1

Marriage, as legal cohabitation, rests on the consorts' moral and legal equality, their feeling of love, respect and mutual understanding, as the basis for domestic unity. Marriage and family shall enjoy special protection by the State.

Article 2

Parents, responsible bodies, and courts shall in their decisions and activities consider the best interest of the child as a high priority.

Article 3

Parents have the obligation and the right to look after the upbringing, development, well-being and education of children born in or out of wedlock.
The State and society must provide families with the necessary support to keep their children with them, so that they are not ill-treated and abandoned, and the family stability is retained.

Article 4

Children born out of wedlock shall enjoy the same rights and obligations as those born in the wedlock.

Article 5

In order to have comprehensive and harmonious development of their personalities all children are entitled to growing up in family conditions and in an atmosphere of joy, love, and understanding.

Article 6

In all the procedures involving children, they shall enjoy the right to being heard, according to their age and capacity to understand, including the right recognised under special provisions guaranteeing their intervention and granting of consent.

Where a minor requires to be heard, his/her request cannot be denied, except ...

LIGJ
Nr. 9887, datë 10.03.2008

PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Neni 2
Parim i përgjithshëm

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. "Të dhëna personale" është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm. Elementet, me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj.
2. "Të dhëna sensitive" është çdo informacion për personin fizik, që ka të bëjë me origjinën e tij racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.
3. "Kontrollues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe, për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale.
4. "Subjekti i të dhënave personale" është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.
5. "Përpunues" është çdo person fizik ose juridik, autoritet publike, agjenci ose çdo njësi tjetër, përveç punonjësve të kontrolluesit, që përpunojnë të dhëna për vetë kontrolluesin.
6. "Sistem arkivimi" është grup i strukturuar të dhënash personale, të aksesueshme sipas, të paktën një kriteri specifik.

LAW
No. 9887 of 10 March 2008

ON THE PROTECTION OF PERSONAL DATA

Pursuant to Articles 78 and 83 (1) of the Constitution of the Republic of Albania, upon the Council of Ministers's proposal

The Parliament
of the Republic of Albania

DECIDED:

CHAPTER I
GENERAL PROVISIONS

Article 1
Scope

The scope of this Law is to establish the rules on the protection and legal processing of personal data.

Article 2
General Principle

The legal processing of personal data shall take place by respecting and guaranteeing fundamental human rights and freedoms, and particularly, the right to privacy.

Article 3
Definitions

For the purpose of this law, the following terms shall mean:

1. "Personal data" is any information about a physical person, who is identified or identifiable. The elements which help identify a person, directly or indirectly include the identity numbers, or other specific physical, psychological, economic, social, and cultural factors.
2. "Sensitive data" is any information about natural persons concerning their racial or ethnic origins, political opinions, membership in trade unions, religious affiliation or philosophical belief, criminal records, and information about their health and sexual life.
3. "Screener" is any physical or legal person, public authority, agency or other unit, which, on their own or in collusion with others, keep, process, manage, file, and for that reason, screens personal data.
4. "Subject of personal data" is any natural person, whose personal data are processed.
5. "Processor" is any natural or legal person, public authority, agency or any other unit, except for the screener's employees, who process data for the screener.
6. "Filing system" is a structured set of personal data, accessible at least basen on a specific criterion.

LIGJ
Nr.9901, datë 14.4.2008

PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

TITULLI I

DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR TREGTARIN
DHE SHOQËRITË TREGTARE

Neni 1

Objekti i ligjit, përkufizime, regjistrime të detyrueshme

1. Ky ligj rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare.
2. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
3. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare mbajnë libra kontabël, hartojnë e publikojnë të dhënat financiare dhe raportet për gjendjen e ecurisë së veprimtarisë, përfshirë dhe raportet e kontrollit të ekspertëve kontabël të autorizuar në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
4. Nëse nuk parashikohet ndryshe, gjykata e përmendur në këtë ligj është seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës, sipas dispozitave të neneve 334 deri në 336 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Dispozitat, që kërkojnë dhënie informacioni në faqen e shoqërisë në internet, mund të zbatohen nëpërmjet krijimit të një lidhjeje informatike të drejtpërdrejtë me faqen në internet, ku Qendra Kombëtare e Regjistrimit publikon informacionin për tregtarin apo shoqërinë përkatëse.
6. Në kuptim të këtij ligji, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës e anasjelltas, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe. Përemri vetor "ai" përfshin edhe përemrin vetor "ajo" dhe përemri vetor "atë" i nënkupton të dyja gjinitë, me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezulton ndryshe.

LAW
Nr.9901, date 14.04.2008

ON ENTREPRENEURS AND COMPANIES

Pursuant to Articles 78, 83 Paragraph 1 of the Constitution, upon the Council of Ministers' proposal

THE PARLIAMENT
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

DECIDED:

PART I
COMMON PROVISIONS

TITLE I

Entrepreneurs and Companies

Article 1
Scope of the Law, definitions, different registrations

(1) This Law regulates the status of entrepreneurs, the founding and managing of companies, the rights and obligations of founders, partners, members, and shareholders, companies' reorganization and liquidation. Companies are gjenral partnerships, limited partnerships, limited liability companies or joint-stock companies.

(2) Entrepreneurs and companies shall register with the National Registration Centre in accordance with this law and Law No. 9723 of 3 May 2007 on the National Registration Centre, as amended.

(3) Entrepreneurs and companies shall keep books, compile and disclose annual accounts and performance reports including verification of authorized auditors in compliance with Law on Accounting and Financial Statements.

(4) If not provided otherwise, the court referred to in this Law is the competent court in accordance with Articles 334 to 336 of the Civil Procedure Code.

(5) Provisions requiring disclosure of information on a company website may be satisfied by establishing an effective link to the registered information held by the National Registration Centre on the concerned entrepreneurs or companies.

(6) As used in this Law, the singular includes the plural and the plural includes the singular, unless the context otherwise requires. The personal pronoun "he" includes "she" and "it"; and the word "him" includes "her" and "it" unless the context otherwise requires.

Neni 2

Tregtari

1. Tregtari është personi fizik, sipas kuptimit të Kodit Civil, i cili ushtron veprimtari ekonomike të pavarur, që kërkon një organizim tregtar të zakonshëm.
2. Personi fizik, i cili ushtron një profesion të pavarur (si avokat, noter, kontabilist, mjek, inxhinier, arkitekt, artist etj.), vlerësohet tregtar, nëse një ligj i posaçëm i ngarkon këtë status.
3. Personi fizik, i cili ushtron veprimtari bujqësore, blegtorale, pyjore e të ngjashme, vlerësohet tregtar, nëse veprimtaria e tij përqendrohet kryesisht në përpunimin dhe shitjen e produkteve bujqësore, blegtorale, pyjore (agrobiznes).
4. Personi fizik, veprimtaria ekonomike e të cilit, për shkak të vëllimit të tij, nuk kërkon një organizim të zakonshëm tregtar (tregtar i vogël), nuk vlerësohet tregtar e nuk i nënshtrohet këtij ligji. Ministri i Financave dhe ministri përgjegjës për ekonominë, me urdhër të përbashkët, miratojnë pragjet e vëllimit të veprimtarisë, në bazë të të cilave lind detyrimi i regjistrimit si tregtar.
5. Tregtari regjistrohet sipas neneve 28 pika 1 dhe 30 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse tregtari ka krijuar një faqe në internet, të gjitha të dhënat e njoftuara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit publikohen në këtë faqe.
6. Tregtari është i detyruar të ndjekë parimet e ndershmërisë profesionale, të zbatueshme në mjedisin tregtar, ku ai vepron. Tregtari, për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara, përgjigjet personalisht me të gjithë pasurinë e të drejtat e tij të tashme dhe të ardhshme, përfshirë pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, pronësitë industriale e intelektuale, kreditë ndaj të tretëve e çdo të drejtë apo pasuri tjetër, vlera e të cilave mund të shprehet në para.
7. Tregtari e humbet statusin e tij kur pushon ushtrimin e veprimtarisë ose kur është i detyruar ta pushojë atë. Në një rast të tillë ai çregjistrohet nga regjistri, në përputhje me nenet 48 deri në 53 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 3

Shoqëritë tregtare

1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).
2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.
3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.

Article 2

Entrepreneurs

- (1) An entrepreneur is a natural person, in accordance with the Civil Code definition, whose independent economic activities require an ordinary business organisation.
- (2) A natural person pursuing an independent profession (such as lawyers, notaries, accountants, physicians, engineers, architects, artists, etc.) is deemed to be an entrepreneur if so provided by special laws.
- (3) A natural person conducting agricultural or forestry activities is deemed to be an entrepreneur if he is mainly organizing the processing and sale of agricultural or forestry products (agro-business).
- (4) Economic activities, which, due to their volume, do not require an ordinary business organization (small scale businesses) are not deemed to be entrepreneurs and are not subjected to this law. The Minister of Finance and the minister responsible for economy shall determine by joint regulation the threshold volume of business at which registration as an entrepreneur is required.
- (5) Entrepreneurs shall register under Art. 28 (1) and 30 of Law No. 9723 of 3 May 2007 on the National Registration Centre. In case an entrepreneur has created a website, all data reported to the National Registration Centre shall be placed on that website.
- (6) Entrepreneurs shall apply the standard of professional diligence that their business environment is entitled to expect. They shall be held personally liable for any obligations deriving from their activities with all their assets, including their movables and immovables, intellectual and industrial property, claims, concessions, and any other property the value of which can be expressed in money.
- (7) An entrepreneur shall lose his status once he ceases or is obliged to cease his activities. In this case he will be deleted from the Registry in accordance with Art. 48 to 53 of Law No. 9723 of 3 May 2007 on the National Registration Centre.

Article 3

Companies

- (1) Companies are founded by two or more persons, who agree on achieving joint economic objectives through contributions defined by the articles of association. Limited liability companies and joint-stock companies may also be formed by one person only (single-member company).
- (2) Companies shall register in accordance with Art. 22 and subsequent articles of Law No. 9723 of 3 May 2007 on the National Registration Centre as relevant to the form of company in question.
- (3) Companies shall acquire legal personality on the date of their registration with the National Registration Centre. They shall be liable with all their assets for the obligations deriving from their activities.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr.96, datë 03.08.2008

PËR AKTIVET NË MBULIM TË PROVIGJONEVE TEKNIKE DHE MATEMATIKE, DHE INVESTIMET E TYRE NGA SHOQËRITË
E SIGURIMEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë:

a) kategoritë e investimeve të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike e matematike;

b) kufijtë maksimalë të lejueshëm të investimit të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike e matematike;

2. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të mbajnë aktive në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, jo më pak se vlera bruto e provigjoneve teknike. Aktivët në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike duhet të jenë të kategorizuara dhe të shpërndara në mënyrë, që të mos jenë të lidhura me një lloj të vetëm aktivi apo enti si dhe të mos jenë të lidhura me detyrime të tjera, përveç atyre që rrjedhin nga kontratat e sigurimit.

3. Shoqëritë e sigurimeve të mbulojnë provigjonet e tyre teknike dhe matematike vetëm me kategoritë e aktiveve, të përcaktuara si më poshtë:

a) bono thesari, obligacione, instrumente të tregut të parasë e të kapitalit, që krijohen apo vërtetojnë borxhin, e emtuar dhe të garantuar, nga organet e qeverisjes qendrore në Republikën e Shqipërisë. Me kërkesë të vecantë të shoqërisë dhe me miratim të Autoritetit, shoqëritë e sigurimit mund të investojnë në instrumentat e lartpërmendur të vendeve anëtare të BE-se, SHBA, Japoni si dhe letra borxhi të garantuara nga organizata ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë bën pjesë;

b) të tjera letra me vlerë, letra borxhi me të ardhura fikse e të ardhura të ndryshueshme, të tregtuara në një treg të rregulluar;

c) aksione në fonde investimesh, brenda territorit të RSH;

d) aksione si pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare, të listuar në një treg të rregulluar ligjërisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

e) aksione në shoqëri sigurimi dhe shoqëri risigurimi, vetëm me miratim të Autoritetit;

f) toka, ndërtesa dhe të drejta mbi pasuri të patundshme në Republikën e Shqipërisë;

g) kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;

h) çertifikata depozitash dhe letra të tjera me vlerë, të lëshuara nga banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë;

i) para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;

REPUBLIC OF ALBANIA
COUNCIL OF MINISTERS

DECREE
No. 96 of 3 August 2008

ON ASSETS COVERING TECHNICAL AND MATHEMATICAL PROVISIONS, AND THEIR INVESTMENT BY INSURANCE
COMPANIES

Pursuant to Article 100 of the Constitution and Article 105 (2) of Law No 9267 of 29 July 2004 "On Insurance and Reinsurance Activities, and Insurance and Reinsurance Intermediation Activities", upon the Minister of Finance's proposal, the Council of Ministers

DECIDED:

1. The purpose of this Decree is to specify:

- a) investment categories for assets covering technical and mathematical provisions;
- b) maximum limits for investing assets covering mathematical or technical provisions;

2. Insurance companies must hold assets to cover their technical and mathematical provisions that cannot be less than the gross amount of technical provisions. Assets covering technical and mathematical provisions must be categorized and distributed in such a way that they are not linked to a single type of assets or entity, and must not be linked to other liabilities except for those deriving from insurance contracts.

3. Insurance companies must cover their technical and mathematical provisions only with the following categories of assets:

- a) Treasury bills, bonds, money and capital market instruments deriving from, or certifying, debt, issued and guaranteed by local governments in the Republic of Albania. After applying with the Authority and receiving its approval, insurance companies may also invest in the abovementioned instruments in EU Member States, USA and Japan, and in debt securities guaranteed by international organizations the Republic of Albania adheres to;
- b) other securities, debt securities with fixed income and variable income, traded on a regulated market;
- c) shares in investment funds in the Republic of Albania;
- d) equity shares of companies listed in a legally regulated market in the Republic of Albania;
- e) shares in insurance companies and reinsurance companies provided this is approved by the Authority;
- f) land, buildings and rights on immovable properties in the Republic of Albania;
- g) individual mortgage housing loans extended only to the staff of the respective insurance company;
- h) certificates of deposit and other securities issued by banks that have been licensed by the Bank of Albania;
- i) cash and cash equivalents (including cash on hand, cash in bank and time deposits with maturity periods of less than 3 months) with banks that have been licensed by the Bank of Albania and the registered offices of which are in the Republic of Albania;
- j) amounts due from reinsurers, which are not pending for more than a year from their accrual;
- k) reinsurers' shares in technical provisions;

- j) shumat që detyrohen nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se një vit nga lindja e detyrimit.
- k) pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike;
- l) depozita me shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;
- m) shumat, që detyrohen nga policmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risigurorese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 3 muaj, por jo me shume se 20 % e provigjonit të primit të pafutuar;
- n) kërkesëpagesa, që rrjedhin nga pjesët e shpëtuara dhe subrogimet, të cilat nuk janë pezull më shumë se 1 vit;
- o) interesa dhe qera të maturuara, të ardhura të tjera të maturuara dhe shpenzime të parapaguara;
- p) aktive të qendrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën «f» të pikës 3 të kësaj VKM, të vlerësuar në bazë të normave të amortizimit;

Nuk do të konsiderohen aktive në mbulim të provigjoneve teknike për shoqërinë e sigurimit:

- a) Aktivitet që shërbejnë për financimin e kapitaleve të veta të një shoqërie sigurimi, apo të një subjekti tjetër që është objekt kufizimesh rregullative nga një Autoritet Mbikëqyrës, brenda të njëjtit grup kapitali.
- b) Letrat me vlerë të shoqërive të cilat janë filiale, shoqëri mbështetëse, aksionerë, në shoqërinë e sigurimit apo çdo rast tjetër që konsiderohet si palë e lidhur me shoqërinë e sigurimit;

4. Shoqëritë e sigurimit, përta i përket aktiveve dhe investimeve të aktiveve, në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike, mund të investojnë jo më shumë se:

- a) 40 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike bruto në letra me vlerë të listuara si dhe letra me vlerë të tregëtuara në një treg të rregulluar dhe pjesëmarrje në fonde investimesh, apo në skemat e investimeve kolektive;
- b) 20 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike bruto në Toka dhe Ndërtesa, përfshirë 10 për qind në çdo pjesë toke a ndërtese ose në një numër pjesësh toke apo ndërtesash, afër njëra tjetrës, sa mund të vlerësohen efektivisht një investim;
- c) 5 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike bruto në aksione dhe letra të tjera me vlerë të listuara në një treg të licensuar letrash me vlerë, si: aksione, obligacione dhe instrumente të tjera të tregut të parasë dhe kapitalit të së njëjtës sipërmarrje apo hua, dhënë të njëjtit huamarrës. Ky kufi mund të ngrihet në 10 për qind nëse sipërmarrja nuk investon më shumë se 40 për qind të provigjoneve teknike bruto në hua ose letra me vlerë të institucioneve emetuese a huamarrëse, ku në secilën prej tyre ka investuar më shumë se 5 për qind të aktiveve të veta;
- d) 10 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike bruto në, letra borxhi, obligacione të garantuara me aktive dhe në aksione që nuk janë të listuara, si dhe të tjera letra me vlerë me të ardhura fikse apo të ndryshueshme, me kusht që investimi i shoqërisë së sigurimit në një subjekt që emeton këto letra me vlerë nuk tejkalon 10 për qind të kapitalit të këtij të fundit;
- e) 5 për qind të provigjoneve teknike dhe matematike bruto në hua të pasiguruara, përfshirë 1 për qind për çdo hua të vetme;
- f) 25 % e vlerës së provigjoneve teknike dhe matematike në shumat që detyrohen nga cesorët, risiguruesit, si dhe pjesa e risiguruesit në provigjonet teknike, në përputhje dhe me pikën 3 (j). Bëjnë përjashtim nga ky kufizim risiguruesit që janë të klasifikuar si BBB- e më lartë nga Standart & Poor;
- g) 3 për qind të provigjoneve teknike bruto në formën e parasë dhe ekuivalentëve të saj;

- l) deposits in ceding companies and debts possessed by them;
- m) amounts due from policyholders and intermediaries deriving from direct insurance and reinsurance activities, if no more than 3 months have passed from the due date, but no more than 20% of the unearned premium provision;
- n) claims deriving from salvaged parts and subrogation that have not been pending for more than a year;
- o) due interests and rents, other due income and advance payments;
- p) tangible fixed assets, except for those provided for in Paragraph 3 (f) of this Decree, valued based on depreciation rates;

The following shall not be considered assets covering technical provisions of insurance companies:

- a) Assets used to finance an insurance company equity or the equity of another entity that is under regulatory restrictions imposed by the Supervisory Authority, within the same equity group;
- b) Securities of companies that are subsidiaries, auxiliary companies or shareholders of the insurance company, or otherwise considered as parties related to the insurance company.

4. Regarding assets covering technical and mathematical provisions and their investment, insurance companies may not invest more than:

- a) 40 percent of their gross technical and mathematical provisions in listed securities and securities traded on a regulated market and shares in investment funds or collective investment plans;
- b) 20 percent of their gross technical and mathematical provisions in land and buildings, including 10 percent in any part of land or building or a number of parts of land or buildings that are sufficiently close to each other to be effectively considered a single investment;
- c) 5 percent of their gross technical and mathematical provisions in shares and other securities listed on a licensed securities market, such as: shares, bonds and other money and capital market instruments of the same undertaking or loans extended to the same borrower. This ceiling may be extended to 10 percent if the undertaking does not invest more than 40 percent of its gross technical provisions in loans or securities of issuing or borrowing institutions, investing more than 5 percent of its assets in each of them;
- d) 10 percent of their gross technical and mathematical provisions in debt securities, secured bonds and shares that are not listed, and other securities with fixed or variable income, provided that an insurance company's investment in an entity issuing such securities does not exceed 10 percent of the equity of the latter;
- e) 5 percent of their gross technical and mathematical provisions in unsecured loans, including 1 percent in each individual loan;
- f) 25 percent of their technical and mathematical provisions in amounts due from ceding companies and reinsurers, and a reinsurer's share in the technical provisions, in accordance with Paragraph 3 (j). This rule shall not apply to reinsurers rated by Standard & Poor as BBB- or above;
- g) 3 percent of their gross technical provisions in the form of cash or cash equivalents;
- h) 5 percent of their gross technical provisions in fixed tangible assets, other than those specified in subparagraph b;
- i) 15 percent of their gross technical provisions in mortgage loans as per the provisions of Paragraph 3 (g), including 5 percent of their net technical provisions in a single loan;
- j) 2 percent of their gross technical provisions in claims deriving from salvaged parts and subrogation, including 1 percent for each individual amount, in accordance with Paragraph 3 (n);

- h) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto në aktive të qëndrueshme të trupëzuara, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën b);
- i) 15 për qind të provigjoneve teknike bruto për kreditë hipotekore, sipas përcaktimit të pikës 3, shkronja g, përfshirë 5 për qind të provigjoneve teknike neto për çdo hua të vetme;
- j) 2 për qind të provigjoneve teknike bruto në kërkesëpagesa që rrjedhin nga pjesët e shpëtuara dhe subrogimet, përfshirë 1 për qind për çdo vlerë individuale, në përputhje me shkronjën n) të pikës 3;
- k) 20 për qind të provigjoneve teknike bruto në depozita me shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;
- l) 5 për qind të provigjoneve teknike bruto në interesa të llogaritur, qira të pagueshme dhe shpenzime të parapaguara;

5. Shoqëritë e sigurimit të cilat janë të licensuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të përshtasin aktivet në mbulim të provigjoneve teknike e matematike dhe kufijtë e investimit të tyre brenda datës 31.03.2008. Për përshtatjen e aktiveve sipas pikës 4 (b) të këtij vendimi, vetëm për periudhën nga hyrja në fuqi e vendimit deri në 30.06.2008, zbatohet kufiri i sipërm në masën 30% të provigjoneve teknike bruto.

6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 28.4.2005 "Për përcaktimin e kufijve maksimale të lejueshëm për aktivet dhe investimet e aktiveve, për mbulimin e provigjoneve teknike dhe matematike, nga shoqëritë e sigurimeve", shfuqizohet;

7. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

- k) 20 percent of their gross technical provisions in deposits with ceding companies and debts owned by them;
- l) 5 percent of their gross technical provisions in accrued interest, payable rent and advances.

5. Insurance companies that have been licensed prior to this Decree entering into force shall adjust their assets covering technical and mathematical provisions and their investment limits by 31 March 2008. The maximum limit of 30 percent of the gross technical provisions shall be applied to adjust assets in accordance with Paragraph 4 (b) of this Decree only from the effective date of this Decree till 30 June 2008.

6. The Council of Ministers Decree no 268 of 28 April 2005 "On Specifying the Maximum Allowed Limits for Assets Covering Technical and Mathematical Provisions and Their Investment by Insurance Companies" shall be repealed.

7. This Decree shall enter into force after its publication in the Official Gazette.

PRIME MINISTER

SALI BERISHA

Në përputhje me vendimin Nr. 201, datë 29.3.2006 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.584, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KËSHILLIT TË MINISTRAVE", projektaktet shqiptare duhet të shoqërohen, ndër të tjera, edhe nga tabela e përputshmërisë me *acquis communautaire* për projektaktet normative. Më poshtë, jepet modeli në shqip i kësaj tablele, si edhe përkthimi në gjuhën angleze, i cili lipset mbajtur parasysh nga përkthyesi gjatë përkthimit të legjislacionit shqiptar në gjuhën angleze.

Tabela 1 e përputshmërisë duhet të përmbajë:

1. Numrin natyror, titullin e plotë dhe numrin në Fletoren Zyrtare të legjislacionit të BE-së që synohet të përafrohet nga projektakti, subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
2. Titulli i projektaktit (aktit), subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
3. Shkalla e përafrimit				
a	b	c	d	e
Pjesët e legjislacionit të BE-së që përafrohen (neni, paragrafi, çështja) (në disa raste mund të përkruhen citime dhe përmbledhje të <i>acquis</i>)	Parashikimet e projektaktit (aktit) (titulli, seksioni, neni, paragrafi, çështja etj.)	Përputhja e projektaktit (aktit) me legjislacionin e BE-së (i plotë, i pjesshëm ose jo i aplikueshëm)	Arsyet për përputhje të pjesshme	Periodha e parashikuar për arritjen e përputhjes së plotë

1. Natural number, full title and the number of publication in the Official Journal of the E legislation, the subject and the objective of its regulatory scope				
2. Title of the draft legislation and the subject and objective of its regulatory scope				
3. Degree of approximation				
a)	b)	c)	d)	e)
Provisions and parts of EU legislation to be approximated with (article, paragraph, issue) (in some cases quotations and summaries of the <i>Acquis</i> might be given)	Provisions of the draft legislation (title, section, article, paragraph, item, etc.)	Compatibility between the draft legislation with the EU legislation (complies fully, complies in part, not applicable)	Reasons for partial compatibility	Date foreseen to achieve full compatibility.

Tabela 2 e përputshmërisë duhet të përmbajë:

1. Titulli i projektaktit (aktit), subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
2. Numrin natyror, titullin e plotë dhe numrin në Fletoren Zyrtare të legjislacionit të BE-së që synohet të përafrohet nga projektakti, subjekti dhe objekti që synon të rregullojë				
3. Shkalla e përafrimit				
a	b	c	d	e
Parashikimet e projektaktit (aktit) (titulli, seksioni, neni paragrafi, çështja etj.)	Parashikimet dhe kërkesat e legjislacionit të BE-së (neni, paragrafi, çështja)	Përputhja e projektaktit (aktit) me legjislacionin e BE-së (i plotë, i pjesshëm ose jo i aplikueshëm)	Arsyet e përputhjes së pjesshme ose të mospërputhjes	Periodha e parashikuar për arritjen e përputhjes së plotë

1. Title of the draft legislation and the subject and objective of its regulatory scope				
2. Natural number, full title and the number of publication in the Official Journal of the E legislation, the subject and the objective of its regulatory scope				
3. Degree of approximation				
a)	b)	c)	d)	e)
Provisions of the draft legislation (title, section, article, paragraph, issue, etc)	Provisions and demands of EU legislation (article, paragraph, issue)	Compatibility between the draft legislation with the provisions of EU legislation (complies, partially complies, not applicable)	Reasons for partial compatibility or non-compliance	Date foreseen to achieve full compatibility.

FJALORËT

1. TERMAT QË KANË LIDHJE ME PUSHTETIN PUBLIK

Në fjalorët, sipas rendit alfabetik, jepen emërtimet e ministrive dhe të organeve të pushtetit publik, midis të cilëve ka edhe nga ato institucione që sot nuk ekzistojnë më ose u janë ndryshuar emërtimet. Megjithatë, duke qenë se në tekste edhe këto emërtime shfaqen, ato përmenden këtu në mënyrë që emërtimet e tyre të përkthehen njëjloj në anglisht. Ju kujtojmë në mënyrë të veçantë që të ndiqni me kujdes jo vetëm përkthimin e emërimit, por edhe mënyrën e shkrimit, pra përdorimin e germave të mëdha/të vogla, etj. Këto veçanti kanë të bëjnë edhe me emërtimet që kanë lidhje me legjislacionin.

1.1 MINISTRITË

Enti shqiptar	shkurt	Përkthimi në anglisht	shkurt
Qeveria e Shqipërisë	QSH	Government of Albania	GoA
Këshilli i Ministrave	KM	Council of Ministers	CoM
Ministria e Punëve të Jashtme	MPJ	Ministry of Foreign Affairs	MoFA
Ministria e Integritimit	MIE	Ministry of European Integration	MoEI
Ministria e Mbrojtjes	MM	Ministry of Defense	MoD
Ministria e Brendshme	MB	Ministry of Interior	Mol
Ministria e Financave	MF	Ministry of Finance	MoF
Ministria e Drejtësisë	MD	Ministry of Justice	MoJ
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	METE	Ministry of Economy, Trade and Energy	MoETE
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	MBUMK	Ministry of Agriculture, Food and Consumer Protection	MoAFCP
Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	MPPTT	Ministry of Public Works, Transportation and Telecommunications	MoPWTT
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	MPÇSSH	Ministry of Labour, Social Affairs and Equal Opportunities	MoLSAEO
Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	MTKR	Ministry of Tourism, Culture, Youth and Sports	MoTCYS
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	MASH	Ministry of Education and Science	MoES
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	MMPAP	Ministry of Environment, Forestry and Water Administration	MoEFA
Ministria e Shëndetësisë	MSH	Ministry of Health	MoH
Minister Shteti		Minister of State	

1.2 NDARJA ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

shqip	anglisht
Qark	Region
Qarku i Tiranës	Region of Tirana
Rreth	District
Rrethi i Skraparit	District of Skrapar

1.3 VENDET E PUNËS, FUNKSIONET DHE NJËSITË ORGANIZATIVE NË ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

shqip	anglisht
Ministria	Ministry
Kabineti	Cabinet
Drejtoria	Directorate
Drejtoria e Përgjithshme	Directorate General
Spektori	Unit
Ministër	Minister
Drejtor kabineti	Chief of Cabinet
Këshilltar ligjor	Legal advisor
Këshilltar ekonomik	Economic advisor
Këshilltar për median	Media advisor
Zëdhënës shtypi	Spokesperson
Zëvendësministër	Deputy Minister
Sekretar i Përgjithshëm	Secretary General
Drejtor departamenti	Director of Department
Drejtor i përgjithshëm	Director General
Drejtor drejtorie	Director of Directorate
Specialist	Expert
Shef sektori	Head of unit
Specialist prokurimesh	Procurement expert
Specialiste e arkiv-protokollit	Filing-protocol expert
Këshilli i Komunës	Communal council
Këshilli Bashkiak	Municipal council
Këshilli i Qarkut	Regional council
Kryetari i komunës	Mayor
Kryetari i Bashkisë	Mayor
Kryetari i Këshillit të Qarkut	Head of regional council
Kryesia e Këshillit të Qarkut	Chairmanship of the regional council
Anëtarë të Këshillit Komunal	Members of the communal council
Anëtarë të Këshillit Bashkiak	Members of the municipal council
Sekretari i Këshillit Komunal	Secretary of the communal council
Sekretari i Këshillit Bashkiak	Secretary of the municipal council
Prefekti	Prefect

1.4 INSTITUCIONET PUBLIKE

shqip	shkurt	anglisht	shkurt
Banka e Shqipërisë	BSH	Bank of Albania	BoA
Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave	AKKP	Property Restitution and Compensation Agency	PRCA
Zyra për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme	ZRPP	Immovable Property Registration Office	IPRO
Departamenti i Administratës Publike	DAP	Department of Public Administration	DoPA
Instituti i Statistikës	IS	Institute of Statistics	IS
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	DPD	Directorate General of Customs	DGC
Drejtoria e Përgjithshme e Tatim-Taksave	DPT	Directorate General of Taxes	DGT
Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe Certifikimit	DPSC	Directorate General of Standardisation and Certification	DGSC
Agjencia e Prokurimit Publik	APP	Public Procurement Agency	PPA
Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit	DPMK	Directorate General of Metrology and Calibration	DGMC
Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave	DPPM	Directorate General of Patents and Trademarks	DGPT
Drejtoria e Akreditimit	DA	Accreditation Directorate	AD
Avokati i Popullit	AP	People's Advocate	PA
Autoriteti i Konkurrencës	AK	Competition Authority	CA
Inspektorati i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Produkteve të Tjera	IKNG	Oil, Gas and other Products Inspectorate	OGI
Agjencia Kombëtare e Energjisë	AKE	National Energy Agency	NEA
Enti Rregullator i Energjetikës	ERE	Energy Regulatory Entity	ERE
Instituti i Studimeve Industriale dhe Projekteve	ISIP	Industrial Research and Design Institute	IRDI
Instituti i Sigurimeve Shoqërore	ISSH	Social Insurance Institute	SII
Instituti i Shëndetit Publik	ISHP	Institute of Public Health	IPH
Agjencia për Inventarizimin dhe Klasifikimin e Pasurive të Paluajtshme	AIKPP	Agency for the Inventory and Classification of Immovable Property	AICIP
Agjencia për Legalizimin, Urbanistikën dhe Integrimin e Zonave Informale	ALUIZI	Agency for the Legalisation, Urbanisation and Integration of Informal Areas	ALUIIA
K Kontrolli i Lartë i Shtetit	KLSH	Supreme State Audit Institution	SSAI
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	AMF	Financial Supervisory Authority	FAS
Instituti i Studimit të Tokave	IST	Land Study Institute	LST
Komisioni i Ndhmës Shtetërore	KNSH	State Aid Committee	SAD
Drejtoria e Patentave dhe e Markave	DPM	Patent and Trademark Office	PTO
Drejtoria e Politikave të Ndërtimit	DPN	Directorate of Construction Policies	DCP
Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit	KKRT	National Radio and Television Council	NRTC
